



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 7, Datë 10.01.2018

MBI

**MIRATIMIN E LICENCËS TIP TË AKTIVITETIT TË SHPËRNDARJES SË GAZIT
NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 22; 23 dhe 50 të Ligjit nr. 102 /2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” si dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.01.2018, mbasi shqyrtoi relacionin për miratimin e licencës Tip për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror, të përgatitur nga Drejtoritë teknike të ERE;

Konstatoi se :

- Me vendimin nr. 161, datë 12.10.2017, ERE ka filluar procedurat për miratimin e Licencës së Shpërndarjes së Gazit Natyror.
- Me shkresën nr.100/52 Prot., datë 17.10.2017, ERE ka vijuar me publikimin me media të njoftimit për fillimin e procedurës për miratimin e Licencës së Shpërndarjes së Gazit Natyror.
- Me shkresën nr. 684 Prot., datë 20.10.2017, ERE ka kërkuar komente dhe opinione nga MIE, MFE, Autoriteti i Konkurrencës, Albgaz sh.a dhe Albpetrol sh.a. Drafti është përcjellë për komente edhe pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
- Në përfundim të afatit të marrjes së komenteve dhe opinioneve nga palët rezultoi se mbi këtë draft-licencë janë shprehur Autoriteti i Konkurrencës, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Albgaz sh.a.. komentet e të cilave janë pranuar kryesisht dhe përpunuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë Licencën Tip për aktivitetin e Shpërndarjes së Gazit Natyror.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI